

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini-Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit G.S., për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor, nga neni 189 par.4 të KPRK-së, duke vendosur, sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, av. S.M., kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.272/2017 të datës 13.12.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.73/2018 të datës 04.04.2018, në seancën e kolegjit, të mbajtur më datë 16 tetor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit G.S., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.272/2017 të datës 13.12.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.73/2018 të datës 04.04.2018.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.nr.272/2017 të datës 13.12.2017, të dënuarin G.S., e ka shpallur fajtor për veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par.4 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) vite, në të cilin është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 30.03.2012 e tutje. Në emër të paushallit gjyqësor është obliguar që ta paguaj shumën prej 200€, kurse i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Me të njëjtin aktgjykim të dënuarit B.A. dhe I.D., janë shpallur fajtor për veprën penale pjesëmarrje në rrahje nga neni 190 i KPRK-së dhe janë gjykuar me dënim burgimi nga 1 (një)

vit, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 30.03.2012 deri me datë 03.02.2014. Në emër të paushallit gjyqësor është obliguar që ta paguaj shumën prej 200€, kurse i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.73/2018 të datës 04.04.2018, ka aprovuar si të bazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me sanksionin penal dhe të dënuarit G.S. i shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) vite, në të cilin dënim i ka llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, kurse ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë e ka refuzuar si të pabazuar.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësja e të dënuarit G.S., avokate S.M. nga Prishtina, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën të ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe të dënuarin ta liroj nga akuza, pasi që ka vepruar në mbrojtje të nevojshme apo veprimet e tij të cilësohen si tejkalim i mbrojtjes së nevojshme apo se veprën penale e ka kryer në gjendje të afektit mendor dhe ti shqiptohet një dënim më i butë ose të i anulohet aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen ta kthejë në gjykatën e shkallës së dytë në rivendosje.

Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit i Kosovës në Prishtinë, me parashtrësën KMLP.II.nr.173/2018 të datës 24.09.2018, ka propozuar, që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit, të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, theksohet se në rastin konkret ka qenë dashur të aplikohet Kodi i Drejtësisë për të mitur, pasi që i dënuari në kohën e kryerjes së veprës penale

ka qenë i moshës nën 21 vjeçare dhe në këto raste nuk ka hapësirë për interpretim por duhet të aplikohen dispozitat që aplikohen ndaj të miturve. Theksohet se edhe gjatë zhvillimit të procedurës në gjykatën e shkallës së parë dhe po ashtu edhe në gjykatën e shkallës së dytë ka pretenduar se ka qenë dashur të veprohet sipas dispozitës së nenit 4 par.2 të KDM dhe asnjëra prej gjykatave nuk ka paraqitur arsyetim përkitazi me këto pretendime dhe se procedura nuk është zhvilluar sipas dispozitave të Kodit të Drejtësisë për të Mitur dhe se po të aplikoheshin këto dispozita ndaj të dënuarit do të shqiptohej dënim më i ulët.

Pretendohet po ashtu se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ka paraqitur arsyetim të detajuar për çdo pikë të aktgjykimit siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 370 par.6 të KPPK-së, përkatësisht nuk ka paraqitur arsyetim për të gjitha çështjet faktike dhe juridike e po ashtu nuk ka vlerësuar në mënyrë të plotë secilën provë por vetëm ka përshtuar deklaratimet e dëshmitarëve dhe me nga një fjali ka theksuar se u beson këtyre dëshmitarëve. Ngjashëm ka vepruar edhe gjykata e shkallës së dytë e cila po ashtu nuk ka evituar shkeljet e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë nuk ka marrë parasysh faktin se kontribues në këtë vepër penale ka qenë vet viktima dhe personat e tjerë që kanë punuar në lokalitë në të cilën është zhvilluar ngjarja dhe se sikur të vlerësohej ky aspekt me siguri se do të konstatohej se në rastin konkret i dënuari ka vepruar brenda mbrojtjes së nevojshme apo kapërcim të mbrojtjes së nevojshme dhe se me këtë rast edhe dënimi i shqiptuar do të ishte më i ulët.

Më tutje në kërkesë pretendohet se në këtë rast nuk është çmuar aspekti i tronditjes mendore të të dënuarit dhe fakti se edhe ekspertiza psikiatrike ka vërtetuar se i dënuari ka vepruar pasi që është sjellë në gjendje të reagimit emocional të intensitetit të lartë dhe duke u kombinuar në faktorët e tjerë konsumimi i alkoolit dhe mosha e tij e re ka mundur të ndikonte në aftësinë e tij për të gjykuar dhe vepruar në mënyrë të drejtë dhe se përkitazi me këto pretendime nuk kanë dhënë arsye as gjykata e shkallës së parë e as gjykata e shkallës së dytë.

Pretendohet po ashtu se me rastin e matjes së dënimit gjykata ka shqiptuar dënim jo adekuat dhe nuk ka pasur parasysh të gjitha rrethanat me rastin e matjes së dënimit dhe se po të i kishte parasysh këto aspekte të dënuarit do të i shqiptonte dënim më të ulët.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e mbajtur shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes dhe në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pasi vlerësoi pretendimet në kërkesë konstatoi se:

kërkesa nuk është e bazuar.

Nuk janë të bazuara pretendimet e paraqitura në kërkesë, se aktgjykimi i shkallës së parë dhe aktgjykimi i shkallës së dytë, janë marrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është paraqitur arsyetim përmbajtësor përkitazi me faktin se nuk janë aplikuar dispozitat e Kodit të Drejtësisë së të mitur dhe atë bazuar në faktin se aplikimi i këtyre dispozitave bëhet vetëm në rastet nga neni 11 i KDM-së, kur madhori i ri të mos i përgjigjet nivelit të vetëdijes dhe formësimit të personalitetit, ndërsa bazuar në ekspertizën psikiatrike rezulton se tek i dënuari nuk manifestohet ngecja në zhvillimin e personalitetit të tij përkatësisht nuk është konstatuar se niveli i zhvillimit nuk i përgjigjet personalitetit të tij, andaj me të drejtë në rastin konkret nuk janë aplikuar dispozitat e KDM-së.

Nuk qëndron pretendimi se në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk janë dhënë arsye për secilën pikë të aktgjykimit, meqë sipas këtij aktgjykimi rezulton se janë dhënë arsye për të gjitha faktet në mënyrë të plotë e veçanërisht lidhur me faktet e vërtetuara dhe të pavërtetuara. Në arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, është vlerësuar secila provë e administruar dhe po ashtu edhe dëshmitë e dëshmitarëve dhe nuk qëndron pretendimi se vetëm janë përshkruar dëshmitë e tyre. Për më tepër jepet vlerësim i plotë për secilën dëshmi dhe pas përshkrimit të dëshmisë edhe vlerësimi i besueshmërisë së saj dhe ndërlidhjes me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë dhe me provat materiale. Në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është arsyetuar veçanërisht edhe pretendimi se pse nuk i besoi versionit të paraqitur nga ana e të dënuarve përkitazi me faktin se ishin sulmuar nga ana e të ndjerit dhe peronave të tjerë në lokal si dhe pretendimi se veprimi i të dënuarit ishte brenda mbrojtjes së nevojshme përkatësisht kalimit të mbrojtjes së nevojshme. Megjithatë mbrojtja e të dënuarit u demantua posaçërisht duke u bazuar në incizimet e bëra përmes kamerës së vendosur në lokal e që nga kjo shihet se të dënuarit kishin iniciuar konfliktin dhe se i ndjeri dhe personat e tjerë nuk kishin ndërmarrë

veprime sulmuese dhe për të cilat pretendime janë paraqitur arsyetime të hollësishme nga gjykata e shkallës së parë në faqen 18 të arsyetimit të këtij aktgjykimi.

Po ashtu përkitazi me pretendimin se tek i dënuari është shkaktuar gjendja e tronditjes mendore dhe nën këtë gjendje është shkaktuar veprimi i tij, me të drejtë gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj të përshkruar në faqe 18 të këtij aktgjykimi ku ka konstatuar se i ndjeri nuk kishte ndërmarre ndonjë veprim konkret kundrejt të dënuarit G.S. përkatësisht nuk e kishte fyer e as sulmuar në asnjë formë e aq më pak në shkallën që kërkohet për tu konsideruar se ka vepruar në gjendje të tronditjes së fortë mendore. Ashtu që sipas dëshmitarëve dhe po ashtu edhe video incizimit qartazi është parë se i ndjeri ka vepruar në drejtim të qetësisimit të situatës dhe jo në drejtim të eskalimit të saj.

Edhe pretendimi tjetër i paraqitur në kërkesë, se në rastin konkret ka qenë dashur të shqiptohet dënim më i ulët bazuar në mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së kësaj vepre penale po ashtu nuk është pretendim i bazuar Nga përmbajtja e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë rezulton se pretendimet kanë për bazë vendimin për dënimin, përkatësisht se nuk janë vlerësuar mjaftueshëm rrethanat lehtësuese përkatësisht se nuk janë aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstatojë se konform dispozitës se nenit 385 par.5 të KPPK, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënimi alternativ, vërejtja gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkalluar kompetencat ligjore.

Andaj në rastin konkret nuk gjeti se kemi të bëjmë me shkelje të tilla të ligjit penal dhe se me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata e shkallës së dytë ka bërë uljen e dënimit të shqiptuar bazuar në ankesën e të dënuarit duke u bazuar në faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale i dënuari ka qenë në moshën e re përkatësisht në kategorinë e personave madhor i ri.

Edhe pse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë bazuar në përmbajtjen e kërkesës, janë paraqitur pretendime për konstatimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mirëpo, këto pretendime nuk janë vlerësuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, meqë bazuar në dispozitën e nenit 432 par.2 të KPPK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e pabazuar dhe konform nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.249/2018, më datë 16 tetor 2018

Bashkëpunëtorja profesionale,
Mirlinda Mejzini-Simnica

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka